VENDIM
Nr.44, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA (OSSH)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 "Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së", paragrafit 5.2 të "Licencës së aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr.71, datë 24.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, dhe vendimit nr.69, datë 24.6.2008 "Për miratimin e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSSH sh.a. për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksionar të shoqërisë OSSH sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), te shoqëria CEZ a.s,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksionar të shoqërisë OSSH sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), te shoqëria CEZ a.s, nga momenti i kryerjes së çdo transferimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta